

Prishtinë, 10/10/2007

Nga: **Z. Ali Hamiti**
Kryesues i Bordit të ZRrE-së

Për: **Z.Remzi Shahini**
Drejtor Menaxhues, KEK Sh.A

Z. Fadil Ismaili
Drejtor Menaxhues, KOSTT Sh.A

Kopje: **Z. Arben Gjokaj**
Drejtor i Divizionit të Rrjetit, **KEK** Sh.A

Z. Fahredin Maqastena
Drejtor i Divizionit të Furnizimit, KEK Sh.A

Znj.Sherife Avdyli
Drejtoreshë për Tarifa dhe Çështje Rregullative, KEK Sh.A

Z.Shefqet Avdiu
Drejtor Ekzekutiv i Gjenerimit, KEK Sh.A

Z. Muhedin Haxhiu
Drejtor i Divizionit të Minierave

Znj.Resmije Ahma
Drejtoreshë për Çështje Ligjore dhe Rregullative, KOSTT Sh.A

Z.Nagip Krasniqi
Drejtor Financiar, KEK Sh.A

Z.Nebih Haziri
Drejtor Financiar, KOSTT Sh.A

Lënda: Shqyrtimi i Tarifave të Energjisë Elektrike 2 (ShTE2) – Parimet dhe Orari

Të nderuar,

Me këtë letër ftohen KEK Sh.A dhe KOSTT Sh.A t'i dorëzojnë për shqyrtim ZRrE-së aplikacionet për tarifat e rishqyrtuara që do të hyjnë në fuqi në vitin 2008. Ky do të jetë shqyrtimi i dytë i tarifave të energjisë elektrike (ShTE2). Kjo letër paraqet parimet të cilat ZRrE-ja konsideron se duhet t'i rregullojë, aplikacionet e tilla dhe orarin tentativ.

Trajtimi i Infrastrukturës së Rrjetit të Bizneseve

ZRrE-ja ka vërejtur se sipas shqyrtimit të parë të tarifave të energjisë elektrike (ShTE1), që ka përfunduar në Maj 2007 për tarifat të cilat kanë hyr në fuqi më 1 Prill 2007, të hyrat e lejuara për operimin e infrastrukturës së bizneseve të Distribucionit të KEK Sh.A dhe KOSTT Sh.A janë vendosur për një periudhë tre vjeçare për kontroll të çmimit, në përputhje me *Metodologjinë e*

*tarifave*¹ të aprovuar nga ZRRE. Sidoqoftë, ZRRE-ja tashmë konsideron se do të jetë e përshtatshme t'i shqyrtojë të hyrat e lejuara për këto biznese së bashku me shqyrtimin e të hyrave të lejuara për bizneset tjera. Kjo arsyeton pasigurinë lidhur me të dhënat e mundshme mbi kostot dhe sasinë të furnizuara nga infrastruktura e rrjetës së bizneseve të KEK Sh.A dhe KOSTT Sh.A në kohën e ShTE² dhe pritjet e ZRRE-së që më pas siguria dhe gatishmëria e të dhënave është përmirësuar. Në vitet pasuese, ZRRE-ja mund të rikthehet në shfrytëzimin e një periudhe rregullative shumëvjeçare për këto biznese.

Prandaj, ZRRE-ja, pret që aplikacionet e tarifave të cilat do të dorëzohen nga KEK Sh.A dhe KOSTT Sh.A të përfshijnë parashikimet e azhuruara të të hyrave të lejuara për të gjitha aktivitetet e rregulluara për vitin 2008. Kjo përfshinë edhe të hyrat të cilat duhet të mbulohen nga tarifatat me pakicë të rregulluara që ju ngarkohen konsumatorëve jo të privilegjuar dhe ngarkesat e rregulluara të transmisionit dhe ngarkesat e shfrytëzimit të sistemit të distribuacionit. (SHST dhe respektivisht SHSSH)

ZRRE-ja pranon se të hyrat e lejuara të miratuara për infrastrukturën e rrjetës së bizneseve të KEK Sh.A dhe KOSTT Sh.A për vitin 2007 ka përfshire një përshtatje të “zbutur”, e cila nuk mbulonte të hyrat e lejuara për vitin 2007 dhe të kompensuar duke lejuar mbulesë më të madhe në vitet e ardhme të periudhës së kontrollit të çmimit.

Parimet e Aplikimit

Mendimi i ZRRE-së është se aplikacionet për shqyrtimin e tarifave duhet të jenë në përputhje me parimet e njëjta sipas ShTE1. Për të ndihmuar në këtë, ZRRE-ja ka përgatitur dy shënime udhëzuese që përmbledhin qasjet për t'i vendosur të hyrat e lejuara dhe tarifatat e rregulluara sipas ShTE1. Këto janë të bashkëngjitura me këtë letër.

Për më tepër, ZRRE-ja propozon që parimet në vijim duhet të zbatohen tek aplikacionet e tarifave të dorëzuara sipas ShTE2:

- Struktura ekzistuese e tarifave dhe kategoritë e konsumatorëve duhet të mbeten të pandryshuara. Këto ishin pranuar vetëm prej datës 1 Prill 2007. Ndryshimet tjera do të reduktojnë stabilitetin dhe parashikueshmërinë e tarifave tek konsumatorët si dhe do të detyrojnë KEK Sh.A të pësoj kosto të reja thelbësore në shqyrtimin e sistemit të faturimit.
- Duhet të ketë një lëvizje graduale në tarifatat që reflektojnë kostot . Tarifatat e shqyrtuara duhet të vazhdojnë të lëvizin kah tarifatat kost reflektive që fillojnë sipas ShTE1, duke përfshirë edhe ri-balancimin e tarifave relative industriale, komerciale dhe shtëpiake, gjersa në të njëjtën kohë janë marrë parasysh edhe çështjet e përbalueshmërisë së pagesës.
- Ngarkesat e ndara të shfrytëzimit të sistemit shpërndarës (SHSSH) duhet të identifikohen. Edhe pse ngarkesat SHSSH janë llogaritur sipas ShTE1, këto nuk ishin miratuar apo bërë të plotfuqishme. Me zgjatjen e pritjes të pragut të privilegjuar sipër të cilit konsumatorët mund të zgjedhin furnizuesin e tyre për të përfshirë konsumatorët të lidhur me rrjetin shpërndarës, do të jetë e nevojshme të vendosen ngarkesat të caktuara të SHSSH.

Orari tregues

¹Gjenden në faqen elektronike të ZRRE-së.

² KOSTT Sh.a është ndarë nga KEK Sh.a kah mesi i vitit 2006. Si rezultat i kësaj, informatat e vitit të plotë dhe parashikimet e buxhetit nuk ishin të gatshme apo të pasigurta.

ZRrE-ja më herët kishte deklaruar qëllimin e vet që të ndërlihdë datën e hyrjes në fuqi të tarifave të reja me vitin financiar (1 Janar deri më 31 Dhjetor). Në vendimet e veta³ të cilat i miratojnë tarifat të cilat hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2007, ZRrE-ja thekson se miratimi është valid gjer më 31 Dhjetor 2007. Prandaj, ZRrE-ja pret që t'i pranojë aplikacionet për shqyrtimin e tarifave në kohën e paraparë që te mund të hyjnë në fuqi nga data 1 Janar 2008. Duke marrë parasysh afatet e ndryshme të caktuara në *Rregullën e Parimeve të Kalkulimit të Tarifave për Sektorin e Energjisë*, ('Rregulla e Çmimeve')⁴ e ZRrE-së, kemi orarin si në vijim për ShTE2:

- Tetor 2007 – nxjerrja e udhëzuesit dhe shabllonëve nga ZRRE.
- Deri më 25 Tetor 2007 – dorëzimi i aplikacioneve të tarifave nga KEK Sh.A dhe KOSTT Sh.A;
- Nëntor 2007 – shqyrtimi i aplikacioneve të tarifave nga ZRrE-ja, duke përfshirë konsultimin e palës me interes.
- Deri më 17 Dhjetor 2007 – vendimi mbi aplikacionet e tarifave nga ZRrE-ja.
- 1 Janar 2008 – data e hyrjes në fuqi të tarifave të reja.

Sidoqoftë, ZRrE-ja është e vetëdijshme për rrethanat e jashtme (posaçërisht negociatat për statusin përfundimtar) mund të ndikojnë në shtyerjen e realizimit të tarifave të shqyrtuara që nga data 1 Janar 2008. ZRrE-ja do të shqyrtojë datën e hyrjes në fuqi të tarifave të shqyrtuara në Dhjetor 2007. Nëse konsideron se nevojitet një shtyrje në paraqitjen e tyre, atëherë tarifat e shqyrtuara pritet të hyjnë në fuqi nga data 1 Prill 2008 (12 muaj pas hyrjes në fuqi të tarifave ekzistuese dhe përputhen me fillimin e sezonës së verës).

ZRrE-ja mirëpret çfarëdo komenti që mund të keni lidhur me parimet dhe orarin e paraqitur në këtë letër. Ju lutem dërgoni komente deri më 15 Tetor 2007. Komunikimet lidhur me këtë letër duhet të adresohen në ERO.PRICING-TARIFFS@eumik.org. Në përputhje me parimin e ZRrE-së për transparencë në punë, kjo letër dhe çfarëdo përgjigje do të publikohen në faqen elektronike të ZRrE-së.

Presim përgjigjen tuaj.

Me respekt,

Dr Ali Hamiti
Kryesues i Bordit të ZRrE-së

Bashkëngjitjet:

- Udhëzuesi i kalkulimit të të Hyrave të Lejuara
- Udhëzuesi i Kalkulimit të Tarifave

³ D_50_2007 dhe D_51_2007 më datë 31 Maj 2007, ndryshimi i vendimeve D_39_2007 dhe D_41_2007 më datë 15 mars 2007. Kopjet e këtyre gjenden në faqen elektronike të ZRRE-së.

⁴ Gjenden në faqen elektronike të ZRRE-së.